



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:259186

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747082

KPPP.nr. 2011/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Beghler Talo” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811866948 dhe me seli në Prizren, fshati Lubizhde, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Liman Musa, avokat nga Ferizaj, kundër debitorit “Beghler” L.L.C., me numër unik identifikues 810974081 dhe me seli në Prizren, fshati Lubizhde, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson zyra e avokatisë “Themis” Sh.P.K., me seli në Prizren, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 369/23 të datës 31.10.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Argjent Xheladini me seli në Viti, jashtë seancës, me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Beghler” L.L.C., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 369/23 të datës 31.10.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Argjent Xheladini, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Beghler Talo” Sh.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 369/23 të datës 31.10.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve; Faturës nr. 250, e datës 13.12.2022, duke detyruar debitorin “Beghler” L.L.C., që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri në emër të borxhit nga fatura e lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 10,311.50, me kamatë ligjore prej 8 % e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetim se urdhri për lejimin e përmbartimit është

marrë në kundërshtim me nenin 71, pika 1.1 të LPP-së, për arsye se detyrimi i përcaktuar nuk ekziston dhe nuk është bërë i arritshëm, ndërsa dokumentet me të cilat është lejuar përmbajtja nuk përmbajnë tipare të përmbartueshmërisë. Më tej, ka theksuar se faturës i mungojnë të dhënat e kreditorit dhe debitorit, nuk është paraparë koha e pagesës, si dhe e njëjta paraqet vetëm regjistrimin e mallrave në depot doganore të palëve në procedurë dhe jo qarkullim të rregullt në mes të subjekteve. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje ndaj prapësimin ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit për arsye se me asnjë provë nuk ka mbështetur të njëjtat dhe se qëllimi i tij është vonesa dhe shtyerja e përmbartimit duke krijuar rrethana të pa qena për të mos paguar detyrimet ndaj kreditorit. Ka shtuar se debitori ka qenë i obliguar që t'ia paguajë kreditorit shumën sipas faturës, e ku konfirmohet pranimi i mallit përmes nënshkrimit dhe vulosjes, ashtu që fatura është paraqitur në origjinal, është nënshkruar dhe vulosur. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e po të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 është përcaktuar se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti faturë nr. 250 e datës 13.12.2022, në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi, në formën e paraqitur, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm për faktin se në përmbartjen e tij nuk evidentohet saktë kreditori

me të dhënat e tij e po ashtu nuk evidentohet as pala debitore dhe të dhënat përcjellëse të tij, elemente këto kumulative që duhet përmbushur sipas nenit 29 par.3 të LPP-së.

Gjykata pati parasysh faktin se në përmbajtjen e këtij dokumenti pasqyrohet vula e kreditorit dhe vula e debitorit, por që nga të njëjtat nuk dihet se cila palë detyrohet nga fatura nr. 250, kjo përderisa në faturë nuk është e përcaktuar se kush paraqitet ofrues i shërbimeve dhe kush paraqitet marrës i shërbimeve.

Andaj, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilës Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, në formën e paraqitur nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Nga si më sipër, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2011/23, datë 28.05.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.